



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142; 22268141

Nr. 1798 Prot.

Tiranë, më 09.11.2017

V E N D I M

Nr. 229, datë 09.11.2017

"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 84, datë 18.07.2017, 'Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017' në Bashkinë Belsh"

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 84, datë 18.04.2017, të Komisionerit.

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 84, datë 18.04.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017", në Bashkinë Belsh.
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:
 1. **Joni Marko** Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
 2. **Migena Haznedari** Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt dhe grumbullimin e të dhënave që materializojnë zbatimin e vendimit, në datat **16 dhe 17 nëntor 2017**.

4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Relacioni duhet të përpilohet deri në datën **01.12.2017**. Më pas do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohet vendimi për përmbylljen e procesit, brenda datës **08.12.2017**.
5. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e verifikimit do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur, Bashkisë Belsh dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të verifikimit me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142; 22268141

Nr. 1798/1 Prot.

Tiranë, 09.11.2017

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 84, datë 18/04/2017, 'Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017'".

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Bashkia Belsh**
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmërues Nr. 84, datë 18.04.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Rregullorja "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 4. Afati i verifikimit:** Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt dhe grumbullimin e të dhënave që materializojnë zbatimin e vendimit, në datat **16 dhe 17 nëntor 2017**.
- 5. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

6. Grupi i punës:

1. **Joni Marko** Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
2. **Migena Haznedari** Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

7. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:

Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni përkatës nga Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbali i mbajtur në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (nëse vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar).

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

- I. Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin Nr. 84, datë 18.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit të akteve të paligjshme të emërimit filluar me Vendimin Nr. 47, datë 13.03.2017”, nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

“1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Belsh, që për rregullimin e ligjshmërisë, të anulojë aktin e emërimit nr. 202, datë 20.05.2016, që ka dalë në kundërshtim me ligjin, për punonjësin *****, në pozicionin e punës, “Specialist Kadastrë”, në Sektorin e Kadastrës, Topografisë dhe Rregjistrimit.

2. Pozicioni i punës, “Specialist Kadastrë”, në Sektorin e Kadastrës, Topografisë dhe Rregjistrimit, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo dhe nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele.

3. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Belsh, të zbatojë vendimin brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.”

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

- II.** Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.
 1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
 2. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Enkelejda HEBIBASI